



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.10.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik “BERISHA COM”, SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084 -521, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “BERISHA COM”, SH.P.K. e dt.09.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 02.10.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 02.10.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “BERISHA COM”, SH.P.K. me dt.09.10.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-Asfaltimi i

rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-6334-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-084 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 17.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi i parë: Sa i përket fenisherit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë me nenin 72 të LPP-së, dhe përgjigjen e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë e ka marrë si të mirëqenë, sepse edhe kontrata është e lidhur për dhënien dhe marrjen e mjeteve me qira dhe si pjesë të saj ka listën e pajisjeve ku përfshihet edhe finisheri. Prandaj ky pretendim i juaji nuk qëndron;

Pretendimi i dytë : lidhur me listën e pajisjeve pretendimi juaj nuk qëndron, sepse tek Lista e pajisjeve në faqen e fundit është lista e pajisjeve siç është kërkuar në FDT-ë:

Numri i Prokurimit: 632-23-6334-5-2-1 – Titulli Ndërtimi-Aasfaltimi i rrugëve në fshatrat Doblibare, Berdosanë, Vraniq dhe Rezinë

LISTA E PAISJEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (copë)	Sasia që ofrohet	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kampiona testi, i tregave, mekanizimi, dëshmitë tibi pronësit ose kontratë për lezimin, foto etj)
1	Ekskavatorë (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale minimum 10t	2	4	Labbere-90226516-[1]viti prodhimit[1986-1990-1995]bobcat-337G-viti prodhimit(2005)
2	Kamion me konstrukcion-ndërtim kiper me peshë totale minimum 12 t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit)	4	9	Man-27-402-viti-1999-Actros-32-45-viti2002-Dajmler-32-35-vit-2002-Actros-11-40-vit-1999-Actros-32-35-viti-2002-VW Man-Fax-s-viti 1995-Man-Tip-18-530-viti-2003-Scania-R500-viti-2007-Man-Tip-35-540-viti-2010
3	Cilindrë apo Bul ngjeshës me peshë totale minimum 7t	2	5	HAMM-HD-75.4K-viti-2008-HAMM-DV-90VO-viti-2005-CATERPILLAR-C-833813-viti-2003-HAMM-HD-14VT-viti-2011-HAMM-HD-10VT-VITI-2009 -14W-219-1213-viti-1998
4	Grujdet	1	2	Caterpillar-M12H-viti1986-O&K-Orestein&Koppel
5	Finisher	1	3	Somima-11A60C-CE-0018-viti2010Vogel-60-90-viti-1994-CatAP500N-viti-2011

Të plotësohet sipas kërkesës dhe dëshmitë në FDT.

Ky Anexë është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton performancën e tyre

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vota _____



RIT: ISO9001 & Tanderë - KURR - Procesi i hapur

Pretendimi i tretë: Lidhur me numrin e punëtorëve të kërkuar, pretendimi juaj nuk qëndron sepse Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar numrin e punëtorëve dhe stafit profesional siç është kërkuar në FDT-ë(18), por në listën e stafit gabimisht janë shkruar nga dy herë numrat 7 dhe 14 (shih në ofertë të Menaxheri i projektit dhe lista e stafit):

**N.N.T "SHKODRANI"
ÇABIQ KLINË**

STAFI I PUNES

Nr	EMRI	MËMBRI	PROFESIONI
1	Ramadan	Gashi	Drëjtor
2	Minevera	Gashi	Menaxhere
3	Shkodrani	Gashi	Udhëheqs ne Kompani
4	Kuqshiri	Gashi	Manipulues
5	Merajim	Gashi	Shofer
6	Rezart	Gashi	Murator
7	Agim	Gashi	Murator
7	Valon	Berisha	Shofer
8	Gene	Berisha	Murator
9	Haki	Berisha	Manipulues
10	Imet	Reshaj	Murator
11	Naser	Haziri	Punter
12	Valon	Millaku	Manipulues
13	Nesimi	Duda	Inzhinjer Memacher i punishteve
14	Ledrim	Osmani	Inzhinjer
14	Hazir	Thuesi	Inzhinjer
15	Sejdi	Berisha	Inzhinjer me Parakontrat
16	Durim	Hogja	Inzhinjer me Parakontrat



Pretendimi i katërt: Sa i përket kërkesave të FDT-së, për qarkullimin bankar, pretendimi juaj nuk qëndron, sepse pasi i janë kërkuar sqarime shtesë Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka sjellur dokumentet e kërkuara dhe me këtë ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi i pestë : lidhur me marrëveshjen e ATK të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk qëndron , sepse këto dokumente i kërkohen Operatorit Ekonomik në fazë të vlerësimit.

Pretendimi i gjashtë lidhur me referencat ne të cilat Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka qenë lider, nuk qëndron, sepse pavarësisht se është apo nuk është lider, ai ka qenë konzorcium me një Operator Ekonomik, i ka përmbushur ato kontrata dhe i pranohen si punë të kryera.

Pretendimi i shtatë – lidhur me planin dinamik të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk qëndron , sepse në kërkesën e Autoritetit Kontraktues në FDT-ë, nuk ka qenë limiti i caktuar, por është kërkuar plani dinamik më i shkurtë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

